

SHTOJCA 3b

Datë: 15/10/2025

TERMA REFERENCE

Subjekti	BEPRO shpk
Objekti i prokurimit:	Zhvillimi i Modulit AI për Lead Scoring dhe Automatizim & Konfigurimi i Infrastrukturës Cloud Agnostike për Platformën NEXORA
Buxheti maksimal (lekë, me TVSH):	2,340,000
Data e nisjes së prokurimit:	15/10/2025
Data e mbylljes së prokurimit:	11/11/2025

1. Përmbledhje

Ky dokument përcakton termat e referencës për kontraktimin e një kompanie teknologjike për zhvillimin e një moduli inteligjence artificiale për vlerësimin automatik të lead-eve (Lead Scoring) dhe për konfigurimin e një infrastrukture cloud agnostike, e cila mund të implementohet në çdo mjedis të përputhshëm cloud (AWS, Azure, GCP, Vercel, Supabase, apo on-prem). Kjo kontratë realizohet në kuadër të programit NOMAD TECH – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve, zbatuar nga LIBURNETIK.

2. Qëllimi

Qëllimi është krijimi i një zgjidhjeje të integruar që:

1. Përdor metoda AI për vlerësimin automatik të lead-eve në CRM-në e NEXORA-s;
2. Siguron një infrastrukturë cloud agnostike të sigurt dhe të shkallëzueshme që mund të deplotet nga BePro në çdo ofrues cloud.

3. Përshkrimi i Shërbimit

1. Zhvillimi i Modulit AI për Lead Scoring dhe Automatizim

- Analizë e të dhënave historike nga CRM-ja NEXORA (Symfony/MySQL).
- Ndërtim i modelit AI që vlerëson automatikisht lead-et duke përdorur qasje hibridë: algoritme klasike (p.sh. regresion logjistik, gradient boosting) dhe/ose LLM (open-source p.sh. LLaMA / Mistral apo closed-source p.sh. GPT API, Claude etj.).
- Vlerësim i modelit me indikatorë saktësie (precision, recall, accuracy) dhe raport i performancës.
- Krijimi i API endpoint-eve REST (POST /score, GET /result, POST /retrain) me autentikim JWT ose OAuth2.

- Dokumentim teknik në format OpenAPI / Swagger dhe udhëzues për mirëmbajtje.
- Dorëzimi i kodit burimor dhe skriptet e përdorura për trajnimin e modelit.

2. Konfigurimi i Infrastrukturës Cloud Agnostike

- Projektim i arkitekturës me parim cloud agnostic.
- Krijimi i mjedisit të deploy-imit me Docker / Compose dhe CI-CD pipeline (GitHub Actions ose alternativë ekivalente).
- Konfigurimi i bazës së të dhënave (PostgreSQL / MySQL) me backup automatik.
- Implementimi i masave të sigurisë: HTTPS, encryption at rest, RBAC, monitorim log-ësh.
- Dokumentim i plotë i infrastrukturës për riprodhim në çdo cloud të përputhshëm.

3. Testim dhe Dorëzim Final

- Testim funksional dhe i performancës në mjedisin cloud agnostik.
- Demonstrim i integritit AI me CRM-në NEXORA (API-first).
- Dorëzimi i raportit teknik final dhe procesverbalit të pranimit të nënshkruar nga BePro

Dorëzimet (Deliverables)

Nr.	Dorëzimi	Përshkrimi	Afati i Dorëzimit
1	Moduli AI për Lead Scoring	Kod burimor, API, raport performancash	≤ 30 ditë
2	Infrastrukturë Cloud Agnostike	Deploy i dokumentuar për çdo cloud të përputhshëm	≤ 30 ditë
3	Fushata digjitale	Konfigurim dhe ekzekutim fillestar i Meta & Google Ads	+30 ditë
4	Raport teknik final dhe dokumentim përdorimi	Manual përdorimi + procesverbal pranimi	≤ 30 ditë

4. Kohëzgjatja

30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit. Çdo ndryshim në afat apo përmbajtje miratohet paraprakisht nga BePro.

5. Kriteret e Përzgjedhjes dhe Vlerësimit

Kriteret Teknike

- Eksperiencë e dokumentuar në zhvillim software
- Oferta teknike për Infranstrukturën agnostike dhe zhvillimin e modulit ai

Kriteret Financiare

- Oferta financiare do të vlerësohet sipas raportit **cilësi/çmim**, ku
 - **70%** peshë për kriteret teknike,
 - **30%** peshë për çmimin më të ulët të pranueshëm.

6. Vlera e Kontratës dhe Pagesat

- **Fondi limit:** 2,340,000 LEK (me TVSH).
- Pagesa do të kryhet në **[2 këste]** përmes transaksionit bankar, pas pranimit të produktit dhe dorëzimit të faturës tatimore.
 - 50 % pas nënshkrimit të kontratës,
 - 50 % pas pranimit përfundimtar të produkteve.
- Nëse fituesi është individ, do të aplikohet **tatimi mbi të ardhurat (15%)** sipas ligjit në fuqi.

7. Dorëzimi i Ofertave

Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues:

8.1.1 Për subjekt fizik/juridik

Nëse oferta paraqitet nga një subjekt fizik ose subjekt juridik, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
- Profili i kompanisë

8.1.2 Për individë (ekspertë të pavarur)

Nëse oferta paraqitet nga një individ si ekspert i pavarur, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- CV e detajuar ku të evidentohet eksperiencia përfshirë arsimimin, eksperiencën profesionale, projektet e mëparshme dhe certifikimet përkatëse.
- Diploma universitare.

8.2 Dokumente Financiare

- Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.
- Ofertën teknike

8.3 Afati dhe Mënyra e Dorëzimit

- Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen **brenda datës 11/11/2025**
- Dokumentet duhet të dorëzohet me email, te gjitha dokumentat e kërkuara duhet te jenë brënda një skedari zip
- Adresa e Dorëzimit do të jetë email i dedikuar për projektin nexora@bepro.al
- Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar nuk do të merret në shqyrtim.

8.4 Verifikimi dhe Kualifikimi

- Dokumentet e dorëzuara do të verifikohen nga autoriteti kontraktues për përputhshmëri me kërkesat e kësaj ftese për ofertë.
- Vetëm subjektet që dorëzojnë **një dokumentacion të plotë dhe të vlefshëm** do të konsiderohen të kualifikuar për fazën e vlerësimit të ofertave.
- Nëse dokumentet janë të paplota ose nuk përmbushin kriteret ligjore, subjekti do të skualifikohet nga procedura.

8.5 Kriteret e skualifikimit

Subjekti do të s'kualifikohet nga procedura nëse:

- Nuk dorëzon një ose më shumë nga dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar.
- Nuk përmbush kushtet ligjore dhe financiare për të ofruar shërbimet.
- Ka paraqitur informacion të pavërtetë ose të pasaktë në dokumentacionin e tij.
- Nuk dëshmon eksperiencën e kërkuar në projekte të ngjashme.